**VENDIM**
**Nr. 366, datë 24.4.2013**

# PËR KALIMIN NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI TË DISA AMBIENTEVE, NGA AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE TE MINISTRIA E FINANCAVE, PËR NJËSINË E MBIKËQYRJES SË LOJËRAVE TË FATIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 15 të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në përgjegjësi administrimi, nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare te Ministria e Financave për Njësinë e Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit të disa ambienteve, sipas planimetrisë dhe formularit bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Dorëzimi i ambienteve të përcaktuara në pikën 2 të këtij vendimi të bëhet pas përfundimit nga AMF-ja të transferimit të pajisjeve në një afat 45-ditor.

3. Ngarkohen Ministri i Financave, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare dhe Kryeregjistruesi i Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletore Zyrtare.

KRYEMINISTRI
**Sali Berisha**

# 1. FORMULARI PER INVENTARIZIMIN E PRONAVE TE PALUAJTSHME SHTETERORE

(Për inventarizimin e pronave të veçanta)

Institucioni Qendrorë: Ministria e Financave

Fusha e përdorimit të pronës: Administratë

| Nr. | A | | | B | | | | | | T t |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Zona Kadastrale dhe indeksi i hartës | Numëri i Pasurisë | Lloji i Pronës | Emri i Pronës (adresa) | Sipërfaqja e pronës: Sipërfaqja Totale (m2) | Nga kjo: Ndërtesë (m2) | Funksioni pë të cilin përdoret Prona | Institucioni me përgjegjësi administrative | Institucioni që e përdor Pronën | |
| 1 | 2 | 3 | 4 | 5 | 6 | 7 | 8 | 9 | 10 | |
| 1 | | 3876 | Ndërtes | Rruga "Perlat Rexhepi", pallati i ri 10 katësh, Tiranë, kati i parë (i banueshëm) i përbërë nga 6 (gjashtë) Zyra, 4 (katër) ballkone dhe 2 (dy) banjoTiranë | 211.00 | 211.00 | Zyra pune | Ministria e Financave | Njësisa e Mbikëqyrjes së Lojrave të Fatit | |

PLANIMETRIA E KATIT TE PARE (SHK. 1:100)

KUOTA + 3.50 (MBI DYQANE)



## PLAN VENDOSJA E GODINES NE PRONEN E FAMILJES SELFOLLARI

SHK 1÷500

## MIRATOHET

PER K.R.T. E BASHKISE SE TIRAN[ES]

KRYETARI

SALI KELMENDI

